

Vendosja e rregullave të qarta për mbrojtjen e natyrës dhe burimeve ujore kontribuon në zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme dhe në ruajtjen e biodiversitetit

Versioni në shqip



Qëndrim i përbashkët i organizatave të shoqërisë civile mbi përfshirjen e Direktivave Kornizë të BE-së për Habitatet, Shpezët dhe Burimet Ujore në Traktatin e Komunitetit të Energjisë

Përmbajtja

Mesazhet kyçe	3
1. Hyrje.....	4
2. Ekonomitë tona varen nga natyra dhe burimet ujore.....	6
3. Natyra e pastër dhe mbrojtja e burimeve ujore janë parakusht për zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme.	6
3.1. Të hyjnë në fuqi masat mbrojtëse të BE-së para shtrirje së energjisë nga era dhe dielli	6
3.2. Zonat e dedikuara për shtrirje të energjisë së ripërtëritshme	7
3.3. Ndërtimet mbi rrjetin Emerald dhe zonat ekzistuese të mbrojtura	9
4. Masat mbrojtëse procedurale që mbështeten në zotimet ekzistuese të Komunitetit të Transportit.....	10
5. Rregullat e qarta u sjellin dobi të gjithëve	11
6. Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë transpozuar tashmë pjesën më të madhe të legjislacionit.....	12
7. Konkluzionet dhe rekomandimet.....	13

Ky material u krijua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e CEE Bankwatch Network dhe Beograd Open School dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Foto: Haliaeetus albicilla, Dennisjacobsen, Adobe Stock

Vendosja e rregullave të qarta për mbrojtjen e natyrës dhe burimeve ujore kontribon në zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme dhe në ruajtjen e biodiversitetit

Qëndrim i përbashkët i organizatave të shoqërisë civile mbi përfshirjen e Direktivave Kornizë të BE-së për Habitatet, Shpezët dhe Burimet Ujore në Traktatin e Komunitetit të Energjisë¹

Mesazhet kyçe

- Përfshirja e Direktivave Kornizë për Habitatet, Shpezët dhe Burimet Ujore në Traktatin e Komunitetit të Energjisë është vendim tejet urgjent. Nëse nuk miratohet në vitin 2026, Ballkani Perëndimor rrezikon të futet në rrugë të energjisë së ripërtëritshme që janë të pasigurta nga ana ligjore, të kontestuara nga ana shoqërore dhe të dëmshme për mjedisin.
- Planifikimi strategjik hapësinor, duke përfshirë përcaktimin e zonave të mbrojtura, mundëson shtrirjen e zbatimit të energjisë së ripërtëritshme. Kriteret dhe procedurat e qarta mjedisore ndihmojnë në minimizimin e pasigurisë, vonesave në projekte dhe kontesteve ligjore të kushtueshme.
- Propozimi i Komisionit Evropian për t'i përfshirë Direktivat e mësipërme në Traktat është i kufizuar, gradual dhe mbështetet në angazhimet ekzistuese ligjore: Palët Kontraktuese kanë transpozuar tashmë pjesë të mëdha të këtij legjislacioni dhe detyrimet ekuivalente të vlerësimit janë tashmë të detyrueshme sipas Traktatit të Komunitetit të Transportit. Integrimi do të siguronte gjithashtu mbështetje thelbësore dhe ekspertizë teknike nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

¹ Shih energy-community.org për më shumë detaje.

1. Hyrje

Tranzicioni energjetik po përparon me ritme të shpejta tek Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë.² Në dhjetor të vitit 2022, Këshilli i Ministrorëve i Traktatit u zotua për objektivat e vitit 2030 për reduktimin e gazrave serrë, efikasitetin e energjisë dhe energjinë e ripërtëritshme, ndërsa instalimi i energjisë diellore dhe asaj të erës është duke u rritur.

Kjo sjell përparësi të shumta, duke përfshirë ajër më të pastër; shmangien e kostove të karburantit; pjesëmarrjen e familjeve dhe bizneseve në gjenerimin e energjisë elektrike; dhe rritjen e qëndrueshmërisë së një sistemi të decentralizuar. Në të ardhmen, kjo do t'i ndihmojë gjithashtu operatorët të shmangin pagesën e kostove të karbonit.

Në të njëjtën kohë, decentralizimi i sektorit të energjisë sjell sfida, duke përfshirë balancimin e zhvillimit të shpejtë të energjisë së ripërtëritshme me mbrojtjen e biodiversitetit dhe ujërave.

Ballkani Perëndimor dhe Kaukazi janë vatra të biodiversitetit në shkallë globale, veçanërisht për sa i përket specieve të ujërave të ëmbla. Malet e gjera të rajoneve, sistemet e lumenjve dhe liqeneve, si dhe bregdeti janë shtëpia e shumë specieve të rrezikuara dhe habitateve të rëndësishme me një shkallë të lartë endemizmi (zhdukjeje). Meqenëse natyra dhe uji mbështesin vetë jetën - duke siguruar ushqim, pije, ajër të pastër, rregullim të klimës, ilaçe dhe materiale ndërtimi - mbrojtja e tyre nuk është opsionale, por një kusht themelor për stabilitetin civilizues dhe për përshtatjen ndaj një klime gjithnjë e më kaotike.

Direktivat Kornizë për Habitatet, Shpezët dhe Burimet Ujore³ janë mjete legjislative të klasit botëror për të siguruar qëndrueshmërinë e natyrës dhe të burimeve ujore të BE-së. Të rafinuara përgjatë dekadave, ato i balancojnë me kujdes detyrimet e zhvillimit me mbrojtjen e biodiversitetit, lumenjve dhe ujërave nëntokësore, duke përfshirë edhe përcaktimin e rrjetit të zonave të mbrojtura Natura 2000.

Themelimi i rrjetit Natura 2000 tradicionalisht ka qenë një nga detyrat e fundit për vendet që po anëtarësoheshin në BE, por kjo gjithmonë ka rritur rrezikun që zonat e vlefshme natyrore të dëmtohen përpara se të mbrohen ligjërisht. Themelimi i Traktatit të Komunitetit të Energjisë pa përfshirë Direktivat Kornizë për Habitatet dhe Burimet Ujore, dhe vetëm me Nenin 4(2) të Direktivës së shpezëve, paraqiste rrezik që projektet e energjisë të shkaktonin dëme të panevojshme në biodiversitet dhe ujëra. Kur u hartua më vonë traktati i tij simotër, Traktati i Komunitetit të Transportit, u mor parasysh nevoja për masa

² Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Gjeorgjia, Kosova, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Ukraina.

³ Këshilli i Bashkimit Evropian, [Direktiva e Këshillit 92/43/KEE e 21 majit 1992 mbi ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër, tekst i konsoliduar](#), 14 korrik 2025; Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian, [Direktiva 2009/147/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 30 nëntorit 2009, mbi ruajtjen e shpezëve të egra, versioni i konsoliduar](#), 26 qershor 2019; Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian, [Direktiva 2000/60/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 23 tetorit 2000, që krijon një kornizë për veprimin e Komunitetit në fushën e politikës së burimeve ujore, versioni i konsoliduar](#), 20 nëntor 2014.

mbrojtëse të shtuara dhe disa pjesë të Direktivave Kornizë për Habitata dhe Burime Ujore u përfshinë për projekte të caktuara transporti (shih më poshtë).

Sot, decentralizimi në rritje i sistemit tonë energjetik do të thotë që mbrojtja e habitateve dhe specieve ekologjikisht të ndjeshme është parakusht edhe më thelbësor për zhvillimin e këtij sistemi. Mbrojtja duhet të bëhet shumë më herët, madje edhe për ato vende, pranimi në BE i të cilave është me vite larg. Për shembull, siç shpjegohet më poshtë, përcaktimi i zonave të dedikuara për shtrirjen e energjisë së ripërtëritshme, siç përcaktohet nga ndryshimet e vitit 2023 në Direktivën e BE-së për Energjinë e Ripërtëritshme, kërkon shmangien e zonave të mbrojtura dhe vendeve të tjera me vlerë të lartë të biodiversitetit, që do të thotë se ato duhet të përcaktohen së pari.

Në fund të vitit 2025, Komisioni Evropian propozoi kapituj të zgjedhur të Direktivës për Shpezët⁴ dhe Direktivës për Habitata,⁵ si dhe Direktivën Kornizë për Burime Ujore dhe direktivat dytësore⁶, për përfshirje në Traktatin e Komunitetit të Energjisë, me një afat të mjaftueshëm pesëvjeçar të transpozimit.⁷

Propozimet nuk i ndryshojnë afatet kohore të vendeve për krijimin e rrjeteve të tyre Natura 2000, por kërkojnë që të merren masa procedurale për të shmangur dëmtimin e Zonave të Rrjetit Emerald me Interes të Veçantë Ruajtjeje, Zonave Kandidate të Rrjetit Emerald me Interes të Veçantë Ruajtjeje, Zonave Ramsar, zonave të mbrojtura në nivel kombëtar që strehojnë lloje habitatesh natyrore dhe specie të listuara në Shtojcat I dhe II të Direktivës 92/43/KEE, dhe zonave të mbrojtura në nivel kombëtar që strehojnë specie zogjsh të përmendura në Nenin 4(2) të Direktivës 2009/147/KE dhe të listuara në Shtojcën I të asaj Direktive.

Ky dokument synon t'u shpjegojë vendimmarrësve dhe akterëve të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë rolin e legjislacionit të BE-së për natyrën dhe burimet ujore që të sigurohet zhvillimi me kohë i energjisë së ripërtëritshme që do të pranohet nga publiku, si dhe të tregojë përfitimet e përbashkëta si për investitorët ashtu edhe për natyrën nga vendosja e rregullave të qarta.

⁴ Neni 2, Neni 4(2) (tashmë pjesë e Traktatit) dhe (4), fjalía e dytë, Neni 5, Neni 9 dhe Shtojca I e Direktivës 2009/147/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 30 nëntorit 2009 për ruajtjen e shpezëve të egra.

⁵ Neni 1, Neni 2, Neni 6(2), (3) dhe (4), Neni 12, Neni 13, Neni 16 dhe Shtojcat I, II dhe IV të Direktivës së Këshillit 92/43/KEE të 21 majit 1992 mbi ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër.

⁶ Direktiva 2000/60/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 tetorit 2000 që krijon një kornizë për veprimin e Komunitetit në fushën e politikave të burimeve ujore; Direktiva 2006/118/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 12 dhjetorit 2006 mbi mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe degradimi; Direktiva 2008/105/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 dhjetorit 2008 mbi standardet e cilësisë mjedisore në fushën e politikave të ujit, që ndryshon dhe më pas shfuqizon Direktivat e Këshillit 82/176/KEE, 83/513/KEE, 84/156/KEE, 84/491/KEE, 86/280/KEE dhe që ndryshon Direktivën 2000/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit; dhe Direktiva e Komisionit 2009/90/KE e 31 korrikut 2009 që përcakton, në përputhje me Direktivën 2000/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, specifikimet teknike për analizën kimike dhe monitorimin e statusit të ujit.

⁷ Parlamenti i Austrisë, [Vorschlag für einen Beschluss des Rates über den im Emrat e Unionit im Ministrat der Energiegemeinschaft zu vertretenden Standpunkt në Bezug auf die Änderungen des Vertrags zur Gründung der Energiegemeinschaft zur Aktualisierung und de Vertrags entsprechend der Entwicklung des Umweltrechts der Union \(38263/EU XXVIII.GP\)](#), 13 tetor 2025.

2. Ekonomitë tona varen nga natyra dhe burimet ujore

Biodiversiteti dhe burimet ujore mbështesin sektorët që janë ekonomikisht të rëndësishëm në vendet e Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë furnizimin me ujë, bujqësinë, turizmin, menaxhimin e përmbytjeve dhe përshtatjen ndaj klimës. Degradimi i këtyre burimeve do të kishte kosto të konsiderueshme afatgjata për ekonomitë dhe buxhetet publike, ndërsa mbrojtja e tyre siguron qëndrueshmëri ekonomike afatgjatë: mbrojtja e biodiversitetit dhe ekosistemeve zvogëlon rreziqet makroekonomike dhe kostot shoqërore afatgjata, duke mundësuar njëkohësisht zhvillim të ekuilibruar.

Ndryshimet klimatike po e rrisin edhe presionin mbi burimet e ujërave të ëmbla në tërë rajonin e Komunitetit të Energjisë përmes thatësirave më të shpeshta, ndryshimit të modeleve të reshjeve dhe rritjes së konkurrencës midis përdoruesve të ujit. Lumenjtë, liqenet, ligatinat dhe gjallesat e ujërave nëntokësore janë thelbësorë për përshtatjen ndaj klimës, furnizimin me ujë, bujqësinë dhe qëndrueshmërinë ekonomike. Përmes menaxhimit të integruar të pellgjeve lumore, Direktiva Kornizë për Burimet Ujore mbron cilësinë dhe disponueshmërinë e burimeve ujore dhe forcon sigurinë afatgjatë të tyre edhe përkundër presionit në rritje nga ndryshimet klimatike.

3. Natyra e pastër dhe mbrojtja e burimeve ujore janë parakusht për zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme

3.1. Të hyjnë në fuqi masat mbrojtëse të BE-së para shtrirje së energjisë nga era dhe dielli

Në BE, instalimi i kapacitetit të energjisë së ripërtëritshme është përshpejtuar gjatë dy dekadave të fundit, dhe në vitin 2025, për herë të parë energjia e erës dhe diellore gjeneruan më shumë energji elektrike në BE (30%) sesa lëndët djegëse fosile (29%).⁸

Ky zhvillim ka ndodhur me masa të forta mbrojtëse të natyrës që janë tashmë në fuqi. Këto kanë dimensione të ndërlydhura hapësinore, procedurale dhe cilësore.

Rrjeti Natura 2000 mbron vendet që janë veçanërisht të ndjeshme dhe ku aktivitetet me ndikime të konsiderueshme në habitatet, hapësirën dhe speciet e synuara duhet të shmangen në përgjithësi. Procedurat e lejeve të hartuara për të balancuar mbrojtjen e natyrës dhe zhvillimin kanë ndihmuar në sigurimin e cilësisë së këtij rrjeti: Vlerësimet e Përshtatshme⁹ për projektet, planet ose programet që mund

⁸ Dr. Beatrice Petrović, [Pasqyrë e Energjisë Elektrike për vitin 2026 në Europë](#), Ember, 22 janar 2026.

⁹ Sipas Nenit 6(3) të Direktivës për Habitatet.

të kenë ndikime të konsiderueshme në zonat Natura 2000 janë një mjet kyç për parandalimin e dëmtimit të zonave të tilla.

Ngjashëm, sipas Direktivës Kornizë për Burimet Ujore, vlerësimet sipas Nenit 4(7) kryhen kur projektet marrin leje që mund të pengojnë arritjen e objektivave cilësore të Direktivës. Projektet e tilla në përgjithësi nuk duhet të vazhdojnë, përveç rasteve të përcaktuara nga Direktiva. Vendosja e masave të tilla mbrojtëse është thelbësore për të siguruar zhvillim të ekuilibruar dhe është një parakusht thelbësor për inovacionet e reja të BE-së, siç janë zonat e dedikuara për shtrirje të energjisë së ripërtëritshme, siç diskutohet më poshtë.

3.2. Zonat e dedikuara për shtrirje të energjisë së ripërtëritshme

Që nga viti 2022, të nxitur nga pushtimi i Ukrainës nga Rusia në masë të madhe dhe nga ndarja e pabarabartë e energjisë së ripërtëritshme midis Shteteve të ndryshme Anëtare¹⁰, Bashkimi Evropian është përpjekur ta përshpejtojë zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme, veçanërisht energjisë diellore dhe të erës. Ndër të tjera, e ndryshoi Direktivën e BE-së për Energjinë e Ripërtëritshme në vitin 2023.¹¹ – një sërë ndryshimesh të njohura si 'RED III', të cilat aktualisht po transpozohen në vendet e BE-së.

Risia kryesore e prezantuar nga RED III është koncepti i planifikimit hapësinor të 'zonave të dedikuara për shtrirje të burimeve të ripërtëritshme' (RAA). Ideja është se këto janë zona pa biodiversitet të konsiderueshëm, ku vendosja e shpejtë e burimeve të ripërtëritshme mund të ndodhë pa shkaktuar dëme të mëdha mjedisore.¹²

Kur caktojnë zona të tilla, autoritetet i japin përparësi:¹³

- sipërfaqeve të ndërtuara dhe atyre artificiale, siç janë çatitë dhe fasadat e ndërtesave,

¹⁰ Për shembull, gjersa Danimarka gjeneroi 50% të energjisë elektrike nga era në vitin 2025 dhe Lituania, Irlanda dhe Suedia gjeneruan të paktën 30%, disa vende, përfshirë Bullgarinë dhe Slloveninë, nuk arritën të kalonin as 3%. WindEurope, [Energjia e erës në Evropë: Statistikat e vitit 2025 dhe perspektiva për vitet 2026-2030](#), 26 shkurt 2026.

¹¹ Parlamenti Evropian, Këshilli i Bashkimit Evropian, [Direktiva \(BE\) 2023/2413 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 18 tetor 2023, që ndryshon Direktivën \(BE\) 2018/2001, Rregulloren \(BE\) 2018/1999 dhe Direktivën 98/70/KE në lidhje me promovimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, dhe shfuqizon Direktivën e Këshillit \(BE\) 2015/652](#), Eur-Lex, 31 tetor 2023.

¹² Sipas RED III, nëse zona të tilla i janë nënshtruar një vlerësimi strategjik mjedisor (VSM) gjatë përcaktimit të tyre, shpesh është e mundur të shmangët kryerja e një vlerësimi të plotë të ndikimit në mjedis (VNM) në nivel projekti për projektet e energjisë së ripërtëritshme në këto zona. Megjithatë, duke marrë parasysh që VSM-të nuk janë të mirë-vendosura në vendet e Komunitetit të Energjisë; se ato kryhen në një shkallë të ndryshme me më pak detaje se VNM-të; dhe se Konventa e Aarhusit kërkon pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore si në nivelin e planit/programit ashtu edhe në atë të projektit, ku këto plane, programe ose projekte mund të kenë ndikime të konsiderueshme mjedisore, ne nuk e rekomandojmë këtë qasje për këto vende. Direktiva VNM është ligjërisht e detyrueshme në Traktatin e Komunitetit të Energjisë, ndryshe nga RED III, për të cilën Palëve Kontraktuese u është rekomanduar vetëm të fillojnë përgatitjen e kushteve ligjore dhe institucionale. Kriteret e shqyrtimit të Direktivës VNM mbeten referenca përfundimtare për të vendosur mbi nevojën për një VNM për projektet e energjisë së ripërtëritshme.

¹³ Neni 15c. Duhet të përdoren të gjitha mjetet dhe grupet e të dhënave të përshtatshme dhe proporcionale për të identifikuar zonat ku termocentralet e energjisë së ripërtëritshme nuk do të kishin një ndikim të madh mjedisor, duke përfshirë hartëzimin e ndjeshmërisë së gjallesave të egra. Duhet të përdoren gjithashtu të dhënat e disponueshme për zhvillimin e rjetit Natura 2000.

- infrastrukturës së transportit dhe mjedisit përreth,
- zonat e parkimit,
- fermat,
- deponitë e mbeturinave,
- zonat industriale,
- minierat,
- trupa artificiale ujorë të brendshëm, liqenet ose rezervuarët¹⁴ dhe, kur është e përshtatshme, vendet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane,
- toka e degraduar e papërdorshme për bujqësi.¹⁵


RAA-të duhet të përjashtojnë gjithashtu zona të caktuara:

- Zonat e Natura 2000,
- zonat e përcaktuara sipas skemave kombëtare të mbrojtjes së natyrës,
- rrugët kryesore migratore të zogjve dhe gjitarëve detarë,
- zona të tjera të identifikuar në bazë të hartave të ndjeshmërisë dhe grupeve të të dhënave dhe mjeteve të tjera, përveç sipërfaqeve artificiale dhe të ndërtuara të vendosura në ato zona.

Disa qeveri të Ballkanit Perëndimor kanë shprehur tashmë interes në zhvillimin e RAA-ve, dhe disa zona të degraduara mund të supozohen në mënyrë të arsyeshme si të përshtatshme për këtë në bazë të të dhënave ekzistuese. Por, për të përcaktuar zona më të mëdha ku burimet e ripërtëritshme mund të përshejtohen në mënyrë të sigurt, autoritetet kompetente duhet të dinë vendet ku nuk është e sigurt ta bëjnë këtë. Mënyra më e qartë për ta bërë këtë është që tashmë ta kemi një rrjet zonash të mbrojtura.

¹⁴ Duhet treguar kujdes këtu, pasi disa trupa ujorë të krijuar nga njeriu kanë vlerë të lartë të biodiversitetit, për shembull pellgje të mëdha me peshq si Saniçani pranë Prijedorit në Bosnjë dhe Hercegovinë.

¹⁵ Toka që është e papërdorshme për bujqësi, por e vlefshme për biodiversitetin, p.sh. toka me shkurre, nuk duhet të përfshihet.



Burimi: *Byroja Evropiane e Mjedisit*, 2022

3.3. Ndërtimet mbi rrjetin Emerald dhe zonat ekzistuese të mbrojtura

Rrjeti Natura 2000 nuk është përcaktuar ende në vendet e Ballkanit Perëndimor, por planifikimi për këtë duhet të përshpejtohet për t'i zvogëluar konfliktet midis ndërtimit dhe ruajtjes së mjedisit. Edhe pse nuk është pjesë e propozimit të Komisionit në lidhje me legjislacionin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor¹⁶ janë zotuar tashmë të krijojnë një rrjet zonash të mbrojtura (Zona Emerald) sipas Konventës së Bernës.

Sipas Nenit 4 të Konventës, secila Palë Kontraktuese obligohet të *'ndërmarrë masa të përshtatshme dhe të nevojshme legjislative dhe administrative për të siguruar ruajtjen e habitateve të specieve të florës dhe faunës së egër, veçanërisht ato të specifikuar në Shtojcat I dhe II, dhe ruajtjen e habitateve natyrore të rrezikuara'*.

Statusi aktual i rrjetit Emerald në Ballkanin Perëndimor është jo i kënaqshëm, por mund të shërbejë si një hap i parë për të vazhduar më tej. Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të mbrojnë me ligj zonat e tyre Emerald dhe të propozojnë zona të reja shtesë. Planet e tyre hapësinore duhet gjithashtu të përditësohen dhe të sigurojnë që brenda zonave të mos zhvillohen aktivitete që shkaktojnë dëme të konsiderueshme ose që kanë ndikime në to.

¹⁶ Kosova nuk është pranuar si anëtare e Këshillit të Evropës, i cili krijoi Konventën e Bernës.

Edhe pse rrjeti Emerald aktualisht është larg të qenit i mjaftueshëm për të përbërë një rrjet zonash të mbrojtura ekuivalente me Natura 2000,¹⁷ deri në vitin 2030, vendet kanë rënë dakord të mbrojnë 35 përqind të specieve dhe habitateve të mbuluara nga Konventa.¹⁸ Ky nuk është zotim i largët që lidhet me anëtarësimin në BE, por obligim veçse i vonuar sipas Konventës së Bernës. Në fakt, Direktiva për Habitatet me rrjetin e saj Natura 2000 u zhvillua në mënyrë që Bashkimi Evropian të përmbushte angazhimet e veta si palë në Konventën e Bernës.

Pra, propozimi i Komisionit duhet të shihet si plotësim i zotimeve ekzistuese. Ai do t'u lejonte vendeve të ndërtonin gradualisht rrjetet e tyre të zonave të mbrojtura, duke përmirësuar njëkohësisht më shpejt mbrojtjet e tyre procedurale bazuar në zonat kandidatë Emerald të propozuara tashmë, zonat e mbrojtura ekzistuese dhe zonat e njohura ndërkombëtarisht.

4. Masat mbrojtëse procedurale që mbështeten në zotimet ekzistuese të Komunitetit të Transportit

Sipas Traktatit të Komunitetit të Transportit, vendet e Ballkanit Perëndimor janë zotuar tashmë t'i zbatojnë Direktivat Kornizë të BE-së për Habitatet dhe Ujërat kur zhvillojnë projekte të infrastrukturës së transportit.¹⁹

Shtojca I.6 e Traktatit i obligon vendet të kryejnë një vlerësim të përshtatshëm të ruajtjes së natyrës, ekuivalent me atë të parashikuar në Nenin 6 të Direktivës për Habitatet, nëse një projekt ka të ngjarë të ndikojë në zona me rëndësi për ruajtjen e natyrës.

Dhe të gjitha projektet e transportit sipas fushëveprimit të Traktatit duhet të zhvillohen dhe zbatohen në përputhje me Nenin 4(7) të Direktivës Kornizë për Ujërat.

Këto vlerësime rast-pas-rasti shqyrtojnë nëse arritja e objektivave të Direktivave do të pengohet si rezultat i aktiviteteve të planifikuara. Nëse po, bëhet një vlerësim nëse do të justifikohet ndonjë përjashtim sipas Direktivave.

Meqenëse vendet janë tashmë të obliguara të përfshijnë dispozita të tilla në legjislacionin e tyre për projekte të caktuara të transportit, ka kuptim që kjo të bëhet edhe për sektorë të tjerë.

¹⁷ Vendet e Ballkanit Perëndimor aktualisht kanë përcaktuar zona Emerald për ta mbrojtur vetëm një përqindje të vogël të specieve dhe habitateve të mbuluara nga Konventa - 0.5 përqind në Bosnjë dhe Hercegovinë, 9.4 përqind në Serbi, 11.3 përqind në Maqedoninë e Veriut, 11.4 përqind në Mal të Zi dhe 19.9 përqind në Shqipëri. Burimi: Konventa e Bernës, [Tabela e Barometrit të Rrjetit Emerald](#), të dhënat e dhjetorit 2025.

¹⁸ Konventa për Ruajtjen e Jetës së Egër dhe Habitateteve Natyrore Evropiane, [Mbledhja e 44-të e Komitetit të Përhershëm](#), [Lista e vendimeve dhe teksteve të miratuara](#), 2 deri 6 dhjetor 2024.

¹⁹ [Traktati themelues i Komunitetit të Transportit](#), 27 tetor 2017.

5. Rregullat e qarta u sjellin dobi të gjithëve

Përveç zotimeve ekzistuese të vendeve dhe nevojës së përgjithshme për qëndrueshmëri natyrore, përmirësimi i kornizës ligjore për të mbrojtur natyrën dhe ujin është gjithashtu thelbësor për arsye pragmatike.

Për investitorët, kjo sjell qartësi dhe zvogëlon rreziqet e vonesave ose anulimeve në fazat e mëvonshme. Pa rregulla të qarta, promotorët e projekteve përballen me rreziqe më të larta gjyqësore, vonesa në leje dhe rritje të kostove të projektit për shkak të pasigurisë dhe kundërshtimeve nga publiku. Kjo është e kushtueshme për të gjithë dhe i dekurajon investitorët. Të kesh rregulla të qarta paraprakisht e bën më të lehtë shmangien e konflikteve të tilla përmes caktimit të objekteve energjetike.

Shumica e vendeve të Komunitetit të Energjisë kanë hasur tashmë rezistencë publike ndaj ndërtimit të hidrocentraleve, të cilat kanë dëmtuar lumenjtë dhe përrenjtë në disa nga zonat më të çmuara dhe të pastra të Ballkanit Perëndimor, pellgun e lumit Dniestër dhe Gjeorgji. Kjo ka përfshirë protesta dhe beteja të gjata gjyqësore. Këto konflikte tregojnë pse planifikimi i hershëm hapësinor, konsultimi kuptimplotë publik dhe mbrojtjet e forta mjedisore janë të nevojshme për të shmangur një reagim të ngjashëm negativ kundër infrastrukturës së energjisë së erës, diellore dhe rrjetit elektrik.

Ndryshe nga hidrocentralet e reja – të cilat kanë potencial të kufizuar në Evropën Juglindore për shkak të ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike dhe ndikimeve të tyre të natyrshme në biodiversitet – energjia diellore, e erës dhe rrjetet e përmirësuara elektrike janë thelbësore për tranzicionin energjetik. Pra, shoqëritë tona nuk mund të përballojnë një reagim negativ ndaj zhvillimit të tyre, pasi kjo do të rrezikonte tërësisht dekarbonizimin.

Gjersa tranzicioni energjetik i BE-së po zhvillohet me rrjetin Natura 2000 dhe masat mbrojtëse për cilësinë e ujit kanë hyrë kryesisht në fuqi - megjithëse kanë nevojë për zbatim më të mirë - vendet e Ballkanit Perëndimor po përpiqen të përshpejtojnë shtrirjen e burimeve të ripërtëritshme pa masa të tilla mbrojtëse. Përpjekja për ta bërë këtë pa një rrjet të fortë zonash të mbrojtura rrit rrezikun e konflikteve mjedisore dhe protestave publike. Mësimi kryesor nga përvoja e BE-së është se shtrirja e burimeve të ripërtëritshme kërkon masa të forta mbrojtëse mjedisore dhe pjesëmarrje publike në mënyrë që të funksionojë.

Ndërkohë që krijojnë rrjetet e tyre të zonave të mbrojtura, më e pakta që vendet mund të bëjnë është të përfshijnë propozimin e Komisionit në Traktatin e Komunitetit të Energjisë dhe të kryejnë vlerësime të Përshtatshme për planet dhe projektet që dihet se janë potencialisht dëmtuese për zonat me vlerë të lartë natyrore - zonat e përcaktuara si kandidatë për Emerald, zonat Ramsar dhe zonat e mbrojtura në nivel kombëtar. Ngjashëm, ato duhet të zbatojnë Direktivën Kornizë për Burimet Ujore kur planifikojnë projekte të energjisë dhe transportit që mund të ndikojnë në trupat ujorë.

6. Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë transpozuar tashmë pjesën më të madhe të legjislacionit

Shumica e vendeve kanë transpozuar një pjesë të madhe të Direktivave Kornizë të BE-së për Habitatet, Shpezët dhe Burimet Ujore, megjithëse ka ende boshllëqe.

Edhe pse disa vende kanë dispozitat kryesore ligjore në fuqi, as Vlerësimet e Përshtatshme sipas Nenit 6(3) të Direktivës së Habiteteve dhe as vlerësimet sipas Nenit 4(7) të Direktivës Kornizë për Burime Ujore nuk kryhen në praktikë kur jepen lejet për projekte²⁰, gjë që mund të ketë ndikime të konsiderueshme negative në zonat e mbrojtura ose të pengojnë arritjen e objektivave të Direktivës Kornizë për Burime Ujore.²¹

Në disa raste kjo ndodhë për shkak të mungesës së legjislacionit zbatues ose transpozimit jo të duhur, por në raste të tjera ndodh sepse Vlerësimet e Përshtatshme janë lidhur vetëm me legjislacionin e Natura 2000 të atij vendi. Në vend të kësaj, ato duhet të lidhen me zona që tashmë janë të mbrojtura ligjrisht, ose të cilat vendet tashmë janë zotuar t'i mbrojnë. Këto përfshijnë zona të nominuara si kandidate Emerald, ose zona që ka të ngjarë të propozohen për rrjetin Natura 2000 në të ardhmen, me të dhëna të rëndësishme tashmë të mbledhura.

Mungesa e vlerësimeve të tilla rezulton në lejin e projekteve që shkatërrojnë trashëgiminë unike natyrore, në shumë raste para se ajo të jetë hulumtuar siç duhet. Këto mangësi në legjislacion rrisin numrin e sfidave ligjore të nisura gjatë procedurave të lejeve dhe rrisin pasigurinë ligjore për investitorët.

Maqedonia e Veriut aktualisht ka një mundësi të shkëlqyer për ta transpozuar pjesën tjetër të Direktivës për Shpezët dhe Habitatet, pasi aktualisht po rishikon Ligjin e saj për Mbrojtjen e Natyrës. Për vende të tjera, si Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina, rregullimet legjislative që do të duheshin bërë për të futur Vlerësimet e Përshtatshme dhe vlerësimet e Nenit 4(7) janë gjithashtu relativisht të vogla dhe nuk do të përbënin një barrë të konsiderueshme.

Kosova mundë të ketë mundësinë ideale gjatë rishikimit të Ligjeve që pritet ta bëjë, Ligjit të natyrës dhe atij të mjedisit, edhe pse nuk është nënshkruese e Konventës së Bernës do të krijonte mundësi dhe bazë ligjore të përshtatshme në nivel vendi.

Në Shqipëri, pavarësisht rekomandimeve dhe shqetësimeve të shprehura si nga shoqëria civile ashtu edhe nga Bashkimi Evropian, transpozimi i Direktivave në legjislacionin kombëtar ende nuk arrin harmonizimin

²⁰ Ose plane apo programe në rastin e Vlerësimeve të Përshtatshme.

²¹ Në shumicën e rasteve kjo ndodhë për shkak të transpozimit selektiv ose vonës në zbatimin e legjislacionit. Për një pasqyrë relativisht të përditësuar të statusit në Ballkanin Perëndimor, shih Maja Pravuljac dhe Matgorzata Smolak, [A po i mbrojnë vendet e Ballkanit lumenjtë e tyre? Një analizë ligjore e standardeve mjedisore në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor](#), ClientEarth, EuroNatur dhe Riverwatch, qershor 2024.

e plotë me *acquis communautaire*. Në veçanti, në lidhje me Ligjin për Zonat e Mbrojtura, institucionet dhe qeveria shqiptare ende nuk kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm për t'i ndryshuar dispozitat që lejojnë dëmtimin e zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit të tyre.²²

7. Konkluzionet dhe rekomandimet

Investimet në energji mund të kenë ndikime serioze në habitatet natyrore, florën dhe faunën. Edhe pse energjia diellore dhe e erës kanë përparësi të shumta mjedisore krahasuar me lëndët djegëse fosile, hidrocentralet dhe termocentralet me biomasë, edhe këto lloje instalimesh mund të shkaktojnë dëm kur ndërtohen në vende të ndjeshme, me ndikime të forta kumulative për shkak të natyrës së tyre të decentralizuar. Me decentralizimin në rritje të sektorit të energjisë, nuk është e arsyeshme që së pari të ndërtohet e pastaj të shtohen masat mbrojtëse mjedisore.

Direktivat e BE-së për Shpezët dhe Habitatet ndihmojnë në sigurinë që instalimet e energjisë të mos ndërtohen në kurriz të trashëgimisë natyrore. Dhe Direktiva Kornizë për Burimet Ujore është thelbësore në minimizimin e ndikimit të projekteve të energjisë në cilësinë e ujit dhe në ekosistemet ujore.

Është shumë e mirëpritur që Komisioni Evropian ka bërë një propozim për të përfshirë pjesë të këtyre Direktivave në Traktatin e Komunitetit të Energjisë, megjithëse do të duhej një afat mjaft i gjërë transpozimi që në realitet duhet të përshpejtohet.

Propozimi i Komisionit arrin një kompromis midis nevojës për të kryer vlerësime të Përshtatshme dhe faktit se do të duhen disa vite që shumica e vendeve të krijojnë rrjete të përshtatshme të zonave të mbrojtura.

Kjo u mundëson vendeve të fillojnë nga aty ku janë tani, duke mbrojtur zonat që tashmë janë përcaktuar si me vlerë të lartë, ndërkohë që vazhdojnë të hulumtojnë dhe të shtojnë zona të tjera.

Zbatimi i këtyre Direktivave është parakusht thelbësor për zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme të decentralizuar në vendet e Komunitetit të Energjisë. Rregullat e qarta dhe të balancuara mirë u sjellin dobi të gjithëve, përfshirë investitorëve, të cilët kanë nevojë për parashikueshmëri dhe qartësi në mënyrë që të planifikojnë projekte që kanë shans të lartë për sukses.

Përfshirja e Direktivave në Traktatin e Komunitetit të Energjisë do t'u mundësojë gjithashtu qeverive të Palëve Kontraktuese të përfitojnë nga ekspertiza e Sekretariatit në transpozim dhe zbatim dhe të ofrojnë ide të reja dhe shkëmbime të praktikave më të mira.

²² PPNEA, [Ruajtja e biodiversitetit brenda Raportit të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor -Vlerësimi i Politikave Kombëtare në Shqipëri](#), Nëntor 2025.

Me theks të veçantë, duke pasur parasysh afatin e gjatë të transpozimit të propozuar nga Komisioni, është thelbësore që të mos lejohen vonesa të mëtejshme në këtë proces dhe që përfshirja e Direktivave të miratohet në Këshillin Ministror të Komunitetit të Energjisë në dhjetor të vitit 2026.

Aarhus center in BiH

Bosnia and Herzegovina



ACEG Center

Albania



Active Mobility Albania

Albania



Albanian Local Capacity Development Foundation (ALCDF)

Albania



Belgrade Open School

Serbia



CEE Bankwatch Network

Regional



CELIM Shqiperi

Albania



Center for Climate Change

North Macedonia



Center for Ecological Education and Sustainable Development

Serbia



Center for Environment

Bosnia and Herzegovina



Center for environmental research and information Eko-svest Skopje

North Macedonia



Center of Modern Skills

Serbia



Climate Action Network Europe

Regional



Connector

Serbia



CoPlan, Institute for Habitat Development

Albania



Critical Education Centre

Serbia



Cross-border network of CSOs "LOR-UNESCO Site"

Albania & North Macedonia



Ecological Movement Padina

Serbia



Ecology and Research Association

Bosnia and Herzegovina



ECOPANA

Kosovo



EcoZ

Kosovo



EDEN center

Albania



Eko akcija

Bosnia and Herzegovina



Eko Centar DELFIN

Montenegro



Eko Element Bugojno

Bosnia and Herzegovina



Eko Forum Zenica

Bosnia and Herzegovina



Ekspertet e Rinj Mjedisor - SHERM

Albania



Energy cooperative Elektropionir

Serbia



Environment Engineering Group

Serbia



Environment Improvement Centre

Serbia



European Environmental Bureau

Europe



European Policy Centre

Serbia



Female initiative

Serbia



Fortress Movement Smederevo

Serbia



Foundation Atelier for Community Transformation - ACT

Bosnia and Herzegovina



Green Home

Montenegro



Group of Rural Activists of Dibra

Albania



ILIRIA

Albania



InoYouth

North Macedonia



Inspira Vivo

Serbia



Institute for Nature Conservation in Albania

Albania



Instituti per Ndryshim e Lidersione ne Shqiperi

Albania



iRevolucija

Serbia



Journalists for Human Rights

North Macedonia



Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit (MMZHT)

Albania



Milieukontakt Albania

Albania



MSJA-Dr Martin Scheider-Jacoby Assoc.

Montenegro



Network Albania

Albania



NGO Eco-team

Montenegro



Non Formal Education Network (ANFEN)

Bosnia and Herzegovina



Novi put

Serbia



Ornithological Society "Naše ptice"

Bosnia and Herzegovina



Platform for Social Development and Innovation

Serbia



Podrinje anti corruption team

Serbia



Polekol

Serbia



Protection and Preservation of Natural Environment in Albania (PPNEA)

Albania



REC - Reconciliation Empowering Communities

Kosovo



Regional Action Lab (Re-ACT Lab)

Kosovo (Regional)



Reset Hub

North Macedonia



RES Foundation

Serbia



Resource Environmental Center Albania (REC Albania)

Albania



Resource Environmental Center Bosnia and Herzegovina (REC BiH)

Bosnia and Herzegovina




Rivers without Boundaries

International



Rural Coalition

North Macedonia



SEED

Montenegro



Shoqata Flag Pine

Albania



Shoqata “Unë Gruaja”, Pogradec

Albania



Team 42

Serbia



Udruga Dinarica Mostar

Bosnia and Herzegovina



UNECOOP

Serbia



United Agro-Environmental Association (Agri-En) Albania



Vojvodina Environmental Movement Serbia



White Heron 1165 Serbia



WWF Adria Regional



Young Researchers of Serbia Serbia



Young Serbian Farmers Serbia



Youth Center Obiliq Kosovo

Youth Cultural Center - Bitola North Macedonia



The project benefits from the support of the Donors Initiative For Mediterranean Freshwater Ecosystems.

This document was produced with the financial assistance of the Donors Initiative For Mediterranean Freshwater Ecosystems. The contents of this document are solely the liability of CEE Bankwatch Network and under no circumstances may be considered as a reflection of the Prince Albert II of Monaco Foundation or Donors Initiative For Mediterranean Freshwater Ecosystems' position.